



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:011462

Datë: 21.11.2024

Numri i dokumentit: 06489193

C.nr. 64/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve H.H dhe F.K, që të dy nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, Ç.M-G nga fshati Fortesë, Komuna e Rahovecit dhe V.M nga Rahoveci, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati L.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit, vlera e objektit të kontestit 1,858.6 euro, jashtë seancës, më datën 21.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve H.K, F.K, Ç.M-Gdhe V.M.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit H.K, në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore prej datës 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 237 ditë pune për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacionet në shumën prej 6.00 euro dhe atë për 70% të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 4.20, apo shumën e përgjithshme prej 995.40 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 09.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm”.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit F.K, në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore prej datës 09.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 291 ditë pune për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacionet në shumën prej 6.00 euro dhe atë për 70% të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 4.20, apo shumën e përgjithshme prej 1,222.2 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 09.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm”.

- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Ç.M-G, në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore prej datës 09.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 312 ditë pune për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacionet në shumën prej 3.00 euro dhe atë për 70% të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 2.10 euro, apo shumën e përgjithshme prej 655.2 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 09.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm”.
- V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses V.M, në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore prej datës 09.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 312 ditë pune për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacionet në shumën prej 3.00 euro dhe atë për 70% të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 2.10 euro, apo shumën e përgjithshme prej 655.2 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 09.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm”.
- VI. REFUZHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit H.H për pjesën tjetër të padisë lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë mbi shumën prej 995.40 euro e deri në shumën prej 1,327.20 euro dhe atë për shumën prej 331.80 euro, për 79 ditë pune.
- VII. REFUZHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit F.K për pjesën tjetër të padisë lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë mbi shumën prej 1,222.2 euro e deri në shumën prej 1,730.40 euro dhe atë për shumën prej 508.2 euro, për 121 ditë pune.
- VIII. REFUZHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses Ç.M-G për pjesën tjetër të padisë lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë mbi shumën prej 655.2 euro e deri në shumën prej 909.30 euro dhe atë për shumën prej 254.1 euro, për 121 ditë pune.
- IX. REFUZHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses V.M për pjesën tjetër të padisë lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë mbi shumën prej 655.2 euro e deri në shumën prej 909.30 euro dhe atë për shumën prej 254.1 euro, për 121 ditë pune.
- X. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve H.K, F.K, Ç.M-Gdhe V.M, t’i paguajë shumën prej 281.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Paditësit H.K, F.K, Ç.M-G dhe V.M përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 09.01.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 1,858.6 euro.

Me datë 14.10.2024 përfaqësuesi i autorizuar i paditësve me anë të parashtrësës ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv.

I njëjti sipas padisë, ka theksuar se paditësit kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë si mësimdhënës në SH.F.M.U “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm, Komuna e Rahovecit, e që për periudhën e kërkuar paditësve 01.01.2020 nga data 01.01.2021 e deri me datën 21.11.2022 i ka takuar e drejta e kompensimit për shpenzimet e udhëtimit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 21.01.2021, por që deri më tani nuk janë kompensuar. Periudha e kërkuar sipas kërkesëpadisë, është nga data 01.01.2020 e deri më 21.11.2022 dhe atë për paditësin H.Hpër 316 ditë të punës, për paditësin F.K për 412 ditë të pranisë në punë, për paditësen Çëndresa Morina – Gashi për 433 ditë të punës, si dhe për paditësen V.Mpër 433 ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 01.07.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Ndërkaq kërkesat që dalin nga kontestet e marrëdhënies së punës fillimisht duhet të parashtrohen tek punëdhënësi. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit.

E njëjta ka theksuar se e konteston në tërësi vërtetimin në formë të kuponave fiskal apo vërtetimet të cilat i nxjerrin shoqatat e transporteve ngase këto shoqata nuk janë kompetente për caktimin e çmimeve të udhëtimit..

Paditësit me padi kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë, të cilën e konteston në tërësi, sepse konsideron se kamata duhet të llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, respektivisht nga dita kur paditësve u njihet e drejta e kompensimit, kur edhe e paditura kuton në bazë të aktgjykimit lidhur me detyrimet financiare që i ka ndaj paditësve.

Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave, për paditësin H.K: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/209 i datës 15.11.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sakip Bellaqa” në Pataqan të Epërm; për paditësin kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/7, e datës 02.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit nëntor 2023, i lëshuar nga T në Prizren.

Për paditësin F.K: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/215 i datës 17.11.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sakip Bellaqa” në Pataqan të Epërm; për paditësin kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/197, e datës 01.09.2023, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit nëntor 2023, i lëshuar nga T në Prizren.

Për paditësen Ç.M-G: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/209 i datës 15.11.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sakip Bellaqa” në Pataqan të Epërm; për paditësen kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/73, e datës 01.09.2019, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit shtator 2023, i lëshuar nga T në Prizren.

Për paditësen V.M: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/206 i datës 31.10.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sakip Bellaqa” në Pataqan të Epërm; për paditësen kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/88, e datës 08.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit tetor 2023, i lëshuar nga T në Prizren.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit për periudhën e kërkuar kohore kanë prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon kompensimi për shpenzimet e udhëtimit si dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit nëntor 2023, i lëshuar nga T në Prizren për paditësin H.K, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Xërxë- Rahovec - Pataqan i Epërm si dhe anasjelltas, Xërxë – Rahovec – Zoqishte 2 herë në javë si dhe anasjelltas është 6 euro në dy drejtime.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/209 i datës 15.11.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sakip Bellaqa” në Pataqan i Epërm, gjykata vërtetoi faktin se paditësi H.K, në periudhën kohore prej datës 01.01.2021 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 316 ditët e punës.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/7, e datës 02.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe

paditësit H.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm, komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit nëntor 2023, i lëshuar nga T në Prizren për paditësin F.K, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Xërxe - Rahovec - Pataqan i Epërm si dhe anasjelltas 1 herë në javë, Xërxë – Rahovec – Zatriq 1 herë në javë si dhe anasjelltas, Xërxë – Rahovec - Pastasel 1 herë në javë dhe anasjelltas, Xërxe - Rahovec -Pataqan i Poshtëm 1 herë në javë dhe anasjelltas, është 6 euro në dy drejtime.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/215 i datës 17.11.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sakip Bellaqa” në Pataqan i Epërm, gjykata vërtetoi faktin se paditësi F.K, në periudhën kohore prej datës 01.01.2020 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 412 ditët e punës.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/197, e datës 01.09.2023, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit F.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm, komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit shtator 2023, i lëshuar nga T në Prizren për paditësen Ç.M-G, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Fortesë-Pataqan i Epërm si dhe anasjelltas është 3 euro në dy drejtime.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/201 i datës 31.10.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sakip Bellaqa” në Pataqan i Epërm, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Ç.M-G, në periudhën kohore prej datës 01.01.2020 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 433 ditët e punës.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/73, e datës 01.09.2019, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses Ç.M-G, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm, komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit tetor 2023, i lëshuar nga T në Prizren për paditësen V.M, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Fortesë-Pataqan i Epërm si dhe anasjelltas është 3 euro në dy drejtime.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/206 i datës 31.10.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sakip Bellaqa” në Pataqan i Epërm, gjykata vërtetoi faktin se paditësja V.M, në periudhën kohore prej datës 01.01.2020 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 433 ditët e punës.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/88, e datës 08.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunes së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses V.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm, komuna e Rahovecit.

Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 paragrafi 1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve për faktin se, paditësi H.H në periudhën kohore nga data 19.04.2021 e deri më 21.11.2022, në vendin e tij të punës ka prezantuar 237 ditë të punës, paditësi F.K në periudhën kohore nga data 09.01.2021 e deri më 21.11.2022, në vendin e tij të punës ka prezantuar 291 ditë të punës, paditësja Ç.M-Gnë periudhën kohore nga data 09.01.2021 e deri më 21.11.2022, në vendin e saj të punës ka prezantuar 312 ditë të punës si dhe paditësja V.Mnë periudhën kohore nga data 09.01.2021 e deri më 21.11.2022, në vendin e saj të punës ka prezantuar 312 ditë të punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësit kanë qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti e ka kontestuar e paditura. Baza juridike e kërkesëpadiësë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”.

Ndërkaq sipas nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që “*Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”. Prandaj, për paditësin H.K, në rast se shumëzohen 309 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 6 euro për çdo biletë (70% i 6 euro = 4.20 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 995.40 euro, për paditësin F.K, në rast se shumëzohen 291 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 6 euro për çdo biletë (70% i 6 euro = 4.20 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 1,222.2 euro, për paditësen Ç.M-G, në rast se shumëzohen 312 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 3 euro për çdo biletë (70% i 3 euro = 2,10 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 655.2 euro, për paditësen V.M, në rast se shumëzohen 312 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 3 euro për çdo biletë (70% i 3 euro = 2,10 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 655.2 euro.

Gjykata ka vendosur ta refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadiësë së paditësit H.K, për faktin se paditësi ka kërkuar të kompensohet për periudhën kohore nga data 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022, për 316 ditët të punës, mirëpo gjykata e refuzoi kërkesën për 79 ditët të punës x 4.20= 331,80 euro, për faktin se nga provat e administruara konkretisht vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Shkollës “Sakip Bellaqa”, vërtetohet se paditësi në periudhën kohore 01.01.2021 e deri më 21.11.2022, në vendin e tij të punës ka prezantuar 316 ditët, mirëpo me kërkesën e precizuar ka kërkuar që të kompensohet nga data 19.04.2021, andaj edhe gjykata ka minusuar ditët e punë për periudhën 01.01.2021 e deri më 19.04.2021.

Për paditësin F.K, për faktin se paditësi në periudhën kohore nga data 01.01.2020 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tij të punës ka prezantuar në 412 ditët e punës, mirëpo gjykata e refuzoi për 121 ditë të punës  $\times 4.20 = 508.2$  euro, për faktin se gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës që përfshin periudhën prej datës 01.01.2020 e deri me datë 09.01.2021.

Për paditësen Çëndresa Morina - Gashi, për faktin se paditësja në periudhën kohore nga data 01.01.2020 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e saj të punës ka prezantuar në 433 ditët e punës, mirëpo gjykata e refuzoi për 121 ditë të punës  $\times 2.10 = 254.1$  euro, për faktin se gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës që përfshin periudhën prej datës 01.01.2020 e deri me datë 09.01.2021.

Për paditësen V.M, për faktin se paditësja në periudhën kohore nga data 01.01.2020 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e saj të punës ka prezantuar në 433 ditët e punës, mirëpo gjykata e refuzoi për 121 ditë të punës  $\times 2.10 = 254.1$  euro, për faktin se gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës që përfshin periudhën prej datës 01.01.2020 e deri me datë 09.01.2021.

Gjykata vlerëson se baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 09.01.2024, prandaj gjykata vendosi si në piken III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadiës së paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me*

*faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën X. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 281.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 260.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil  
C.nr.64/2024, më datën 21.11.2024

B.Profesionale  
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.